

Thet sot që është në zbatim ligj' i ri. Për ta shëndoshë trashëgimi!

Të mos ndruarit e frymës së moçme provohet edhe në kohën e tanishme me rastin e zgjedhjeve komunale, kur Mirditasi preferon si këshilltarë ata që kanë patur ofiqe të ndryshme “den baba den”. Do kohë që të çduket ky mentalitet primitif. T’ a ngutësh shumë kujton se vepëron kundra interesave të tij edhe kështu bëhet i rezikëshme,

Dyke marë parasysh se kanë kaluar kaq shpejt edhe as më i pakëti përparim nuk është bërë në Mirditë, munt të thuhet se Kryetarët përpiqeshin më tepër për veten e tyre sesa për imbaravajtjen e popullit që udhëhiqnin. Thoshin se përpiqeshin për mprojtjen e privilegieve që kishin patur, kurse në realitet i siguronin shtëpisë së tyre një të ardhur më të madhe. Nënë udhëheqjen e tyre janë vrarë edhe janë prerë, gjoja se do t’ u vinte një mirësi e madhe, mirëpo cili ka qënë përfundimi? Këta kanë paguar çpërblimin që s’ munt të zihet në numur me gjakun e tyre, kurse Kryetarët kanë dalë fitimtarë materialisht.

Fatmirësisht sot, për Mirditasit vetë ashtu edhe për Shqipërin’ e tërë, xheku dëgjon të thonë: “Na kena pas kenë budallë; ina vra e ina prë pa dobi; shpijat na jan djek e kina mbet